



Sesioni i 78-të i PKDNj-së

Sesioni i rregullt i 78-të i radhës i [Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut](#) (Paneli) është mbajtur prej datës 9 deri më 14 dhjetor 2014. Paneli ka miratuar 7 mendime lidhur me 15 ankesa. Paneli ka për t'i shqyrtuar edhe 88 ankesa. Të gjitha të dhënat statistikore mund t'i gjeni në gjuhën [angleze](#), [shqipe](#) dhe [serbe](#).

Llella Nikolliq dhe të tjerët kundër UNMIK-ut (lëndët nr. 72/09, 73/09, 74/09, 75/09, 76/09, 78/09, 95/09 dhe 96/09)

Ankesat e **znj. Llella Nikolliq** kanë të bëjnë me të afërmit e saj të ngushtë: njerikën, **znj. Darinka Shutakoviç** (lënda nr. 72/09), babanë, **z. Nedelko Shutakoviç** (lënda nr. 75/09), dhe tre djemtë e tyre: **Radovan Shutakoviç**, 10 vjeçar (lënda nr. 73/09), **Gjorgje Shutakoviç**, 16 vjeçar (lënda nr. 74/09) dhe **Alleksandar Shutakoviç**, 18 vjeçar (lënda nr. 76/09); ankesa e **znj. Rosanda Kabash** ka të bëjë me vëllain e saj, **z. Millenko Kabash**; ankesat e **z. Millan Petroviç** kanë të bëjnë me prindërit e tij, **z. Miça Petroviç** dhe **znj. Radmilla Petroviç** (lëndët nr. 95/09 dhe 96/09). Të afërmit e ankueses kanë jetuar në të njëjtin objekt banesor në Gjakovë. Përafërsisht në kohë të njëjtë, në qershor të vitit 1999, pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) të gjithë i kishin kidnapuar. Që nga ajo kohë vendndodhja e tyre mbetet e panjohur.

Paneli ka ardhur në përfundim se UNMIK-u nuk ka kryer hetim të efektshëm për kidnapimin dhe zhdukjen e personave të lartpërmendur, duke shkelur kështu të drejtat e ankueses, të parapara në nenin 2 (procedurale) dhe se sjellja e UNMIK-ut ka kontribuar në vuajtjet shpirtërore të ankueses (shkelja e nenit 3 të KEDNj-së, substanciale). Teksti i Mendimit do të botohet në faqen e internetit të Panelit brenda përafërsisht një muaji.

Gavrillo Millosavleviq kundër UNMIK-ut (lënda nr. 163/09)

Ankuesi është djali i **znj. Lubomirka Gjuriq**, e cila raportohet të jetë kidnapuar nga banesa e saj në Istog diku mes datave 2 dhe 5 korrik 1999. Vendndodhja e saj ende mbetet e panjohur.

Paneli ka ardhur në përfundim se UNMIK-u nuk ka kryer hetim të efektshëm për rastin e **znj. Lubomirka Gjuriq** (shkelja e nenit 2 të KEDNj-së, procedurale) dhe se sjellja e UNMIK-ut ka kontribuar në vuajtjet shpirtërore të ankueses (shkelja e nenit 3 të KEDNj-së, substanciale). Paneli gjithashtu ka cekur se dosja hetimore lidhur me **z. M.P.** dhe **znj. S.P.**, dy persona që gjithashtu janë zhdukur nga Istogu rreth të njëjtës kohë me **znj. Lubomirka Gjuriq**, tregon, madje se edhe me kufizimet e ngritura nga PSSP-ja, sa i

hollësishëm mund të jetë hetimi i Policisë së UNMIK-ut. Teksti i Mendimit do të botohet në faqen e internetit të Panelit brenda përafërsisht një muaji.

Vinogorka Jovanović kundër UNMIK-ut (lënda nr. 222/09)

Ankesa është parashtruar nga znj. Vinogorka Jovanović, vajza e **z. Svetislav Jakshiq**, i cili raportohet se është kidnapuar më datën 5 korrik 1999 nga vetura e tij nga një grup të rinjsh, derisa po priste në semaforë në Prishtinë. Ai më nuk është parë i gjallë.

Paneli ka ardhur në përfundim se UNMIK-u nuk ka hetuar në mënyrë të duhur krimin e supozuar, duke shkelur kështu të drejtat e ankueses, të parapara në nenin 2 (procedurale) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Teksti i Mendimit do të botohet në faqen e internetit të Panelit brenda përafërsisht një muaji.

Draginja Vujačić kundër UNMIK-ut (lënda nr. 226/09)

Ankesa është parashtruar nga znj. Draginja Vujačić, bashkëshortja e **z. Slobodan Vujačić**, motra e **z. Luka Petrushić** dhe kunata e **znj. Radmilla Petrushić**, të cilët raportohet se pjesëtarët e UÇK-së i kanë kidnapuar më 17 qershor 1999 nga shtëpia e tyre në Banjë të Pejës, komuna e Istogut. Që nga ajo kohë, vendndodhja e të tre personave mbetet e panjohur. Ankuesja pretendon se UNMIK-u nuk ka hetuar në mënyrë të duhur kidnapimin dhe vrasjen e mundshme të anëtarëve të familjes së saj, gjë e cila gjithashtu ka shkaktuar vuajtje shpirtërore.

Paneli ka ardhur në përfundim se UNMIK-u nuk ka hetuar në mënyrë të duhur krimin e supozuar, duke shkelur kështu të drejtat e ankueses, të parapara në nenin 2 (procedurale) dhe nenin 3 (substanciale) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Teksti i Mendimit do të botohet në faqen e internetit të Panelit brenda përafërsisht një muaji.

Z.B. kundër UNMIK-ut (lënda nr. 229/09)

Ankesa është parashtruar nga bashkëshortja e **z. L. B.**, serb etnik, të cilin raportohet se e ka kidnapuar UÇK-ja më 9 qershor 1998 dhe më pastaj raportohet se është transferuar dhe mbajtur në arrest në kampin e KFOR-it Bondstill. Fati i tij mbetet i panjohur.

Paneli ka ardhur në përfundim se UNMIK-u nuk ka hetuar në mënyrë të duhur krimin e supozuar, duke shkelur kështu të drejtat e ankuesit, të parapara në nenin 2 (procedurale) dhe se sjellja e UNMIK-ut ka kontribuar në vuajtjen shpirtërore të ankuesit (shkelja e Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, neni 3, substanciale). Teksti i Mendimit do të botohet në faqen e internetit të Panelit brenda përafërsisht një muaji.

Bogolub Shmigić kundër UNMIK-ut (lëndët nr. 264/09 dhe 265/09)

Ankesën e ka parashtruar djali i **z. Millosav Shmigić** dhe **znj. Sulltana Shmigić**, serbë etnikë, të cilët raportohet se janë kidnapuar nga pjesëtarët e UÇK-së më 9 qershor 1998 së bashku me banorët e tjerë serbë të Kosovës që kishin mbetur në fshatin Leçinë. Fati i tyre ende mbetet i panjohur.

Paneli ka ardhur në përfundim se UNMIK-u nuk ka hetuar në mënyrë të efektshme kidnapimin dhe zhdukjen e **z. Millosav Shmigić** dhe **znj. Sulltana Shmigić**, duke shkelur kështu të drejtat e ankuesit, të parapara në nenin 2 (procedurale) dhe se sjellja e UNMIK-ut ka kontribuar në vuajtjen shpirtërore të

ankuesit (shkelja e Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, neni 3, substanciale). Teksti i Mendimit do të botohet në faqen e internetit të Panelit brenda përafërsisht një muaji.

Marija Stevanović kundër UNMIK-ut (lënda nr. 289/09)

Ankuesja është nëna e **z. Dragan Stevanović**, serb etnik, të cilin UÇK-ja e kishte kidnapuar më 19 gusht 1999, së bashku me z. Ivan Majstorović (i cili i kishte vetëm 17 vjet), derisa po udhëtonin me automjetin e z. Dragan Stevanović. Që nga ajo kohë vendndodhja e tyre mbetet e panjohur. Ankuesja ankohet për dështimin e supozuar të hetimit të duhur të kidnapimit dhe zhdukjes së djalit të saj dhe për vuajtjet shpirtërore që supozohet t'i jenë shkaktuar asaj dhe familjes së saj si pasojë e kësaj situatë.

Lidhur me mbylljen e hetimeve, Paneli në veçanti ka vënë re se dosja është mbyllur pas fillimit të zbatimit të politikës së përgjithshme, të krijuar në vitin 2003 nga Departamenti i drejtësisë i UNMIK-ut dhe nga Policia e UNMIK-ut, që kryesisht kishte për qëllim ruajtjen e resurseve të kufizuara dhe përqendrimin vetëm në hetime “me gjasë të madhe të identifikimit të të dyshuarit”. Sipas pikëpamjes së Panelit, kjo politikë ka pasur ndikimit të madh në këtë hetim, dhe me siguri edhe në hetimet e tjera të natyrës së ngjashme. Paneli e konsideroi këtë si “tregues të dështimit serioz të sistemit në procesin e funksionimit të sistemit policor dhe të drejtësisë, të krijuar nga UNMIK-u”, në shkëputje të qartë mes gjendjes në terren dhe mënyrës si është paraqitur e njëjta tek palët kryesore me interes”.

Paneli ka ardhur në përfundim se UNMIK-u nuk ka kryer hetim të efektshëm lidhur me kidnapimin dhe zhdukjen e z. Dragan Stevanović dhe se ka pasur shkelje të nenit 2 (procedural) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, ku përmes sjelljes së tij UNMIK-u ka kontribuar në vuajtjet dhe shqetësimet shpirtërore të ankueses, gjë që paraqet shkelje të nenit 3 të KEDNj-së. Teksti i Mendimit do të botohet në faqen e internetit të Panelit brenda përafërsisht një muaji.

Mendimet e mëhershme tani të publikuara

Paneli në faqen e internetit të tij tanimë ka publikuar mendimet vijuese, të cilat janë miratuar nga Paneli gjatë [sesionit të tij të 76-të në tetor të vitit 2014](#):

Dobrilla Antiq-Zhivković kundër UNMIK-ut (Lënda nr. 147/09)

Ankuesja është nëna e **z. Zlatko Antiq**, i cili raportohet të jetë kidnapuar nga pjesëtarët e UÇK-së në Prizren më 28 korrik 1999 derisa ka qenë duke e vizituar fqinjin së bashku me një person tjetër. Që nga ajo kohë ai nuk është parë më i gjallë. Emri i Zlatko Antiqit përmendet në dokumentin e tetorit të vitit 2003, të përgatitur nga Departamenti i drejtësisë i UNMIK-ut për TNPJ-në lidhur me dyshimet për trafikimin me qenie njerëzore nga UÇK-ja për qëllime të prostitucionit të detyruar dhe tregtisë me organe.

Paneli ka ardhur në përfundim se UNMIK-u nuk ka bërë hetimin e duhur të krimit të supozuar, duke shkelur kështu të drejtat e ankueses, të parapara në nenin 2 (procedurale) ku përmes sjelljes së tij UNMIK-u ka kontribuar në vuajtjet dhe shqetësimet shpirtërore të ankueses, gjë që paraqet shkelje të

nenit 3 të KEDNj-së. Teksti i plotë i Mendimit të Panelit mund të shikohet këtu në [anglisht](#), [shqip](#) dhe [serbisht](#).

Bosilka Radovanoviq kundër UNMIK-ut (lënda nr. 177/09)

Ankuesja është bashkëshortja e z. **Radovan Raçiq**, i cili u zhduk më 11 qershor 1999. Ai raportohet të jetë vrarë nga një grup i paidentifikuar i shqiptarëve para banesës së tij, në prani të një dëshmitari okular, të cilit nuk i është cekur emri. Pas vrasjes, kufoma e tij është dërguar në një vend të panjohur. Mbetjet mortore më vonë janë gjetur afër fshatit Ramoc të komunës së Gjakovës. Mbetjet mortore i janë dorëzuar ankuseses më 25 qershor 2007.

Paneli ka ardhur në përfundim se UNMIK-u nuk kishte hetuar në mënyrë të duhur krimin e supozuar, duke shkelur kështu të drejtat e ankuseses, të parapara në nenin 2 (procedurale) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Teksti i plotë i Mendimit të Panelit mund të shikohet këtu në [anglisht](#), [shqip](#) dhe [serbisht](#).

Ollivera Budimir kundër UNMIK-ut (lënda nr. 219/09)

Ankuesja është e veja e z. **Rade Budimir**, e cila deklaroi se më 2 gusht 1999, z. Rade Budimir është kidnapuar nga banesa e nënës së tij në Prishtinë. Ai nuk është parë i gjallë më. Ankuesja gjithashtu thotë se më 5 gusht 1999, KFOR-i ka arrestuar katër të dyshuar në banesën e z. Rade Budimirit, por duket se nuk janë filluar procedurat penale kundër tyre. Mbetjet mortore të z. Rade Budimirit në fund janë gjetur dhe i janë kthyer familjes së tij më 13 shtator 2002.

Paneli ka ardhur në përfundim se UNMIK-u nuk kishte hetuar në mënyrë të efektshme kidnapimin dhe vrasjen e z. Rade Budimir, duke shkelur kështu të drejtat e ankuseses, të parapara në nenin 2 (procedurale) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Teksti i plotë i Mendimit të Panelit mund të shikohet këtu në [anglisht](#), [shqip](#) dhe [serbisht](#).

Angellina Bishevac kundër UNMIK-ut (lënda nr. 223/09)

Ankuesja është vajza e z. **Radota Gojkoviq**, për të cilin raportohet se në qershor të vitit 1999 e kanë kidnapuar pjesëtarët e UÇK-së në Pejë. Mbetjet e tij mortore më vonë janë gjetur, identifikuar dhe i janë kthyer familjes më 18 shkurt 2003.

Paneli ka ardhur në përfundim se UNMIK-u nuk kishte hetuar në mënyrë të efektshme zhdukjen dhe vrasjen e z. Radota Gojkoviq, duke shkelur kështu të drejtat e ankuseses, të parapara në nenin 2 (procedurale) të KEDNj-së. Teksti i plotë i Mendimit të Panelit mund të shikohet këtu në [anglisht](#), [shqip](#) dhe [serbisht](#).

Sllagjana Remishtar kundër UNMIK-ut (lënda nr. 245/09)

Ankuesja është bashkëshortja e z. **Nenad Remishtar**, i cili ka punuar si polic i komunikacionit në stacionin policor të Gjakovës. Ajo raporton se pjesëtarët e UÇK-së e kanë kidnapuar më 13 qershor 1998, derisa po ngiste veturën e tij. Më pas ai është dërguar në objektin e UÇK-së për mbajtje në arrest në arrest në fshatin Jabllanicë të komunës së Gjakovës dhe më vonë është ekzekutuar. Mbetjet e tij mortore ende nuk janë gjetur.

Kidnapimi dhe vrasja e mundshme e z. Nenad Remishtar është hetuar nga TNPJ në kuadër të procedurës në lëndën *Prokurori kundër Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt* ([IT-04-84](#)).

Duke shprehur keqardhjen që hetimet dhe procedura gjyqësore në TNPJ, si dhe ato të kryera nga UNMIK-u, nuk kanë mundur të identifikojnë personat përgjegjës për kidnapimin dhe vrasjen e mundshme të z. Nenad Remishtar dhe t'i sjellin ata para drejtësisë, Paneli erdhi në përfundim se, për aq sa ky hetim i atribuohet autoriteteve të UNMIK-ut, nuk ka pasur shkelje të nenit 2 (procedural) të KEDNj-së. Duke marrë parasysh rrethanat e caktuara të rastit dhe pasi që nuk ka konstatuar shkelje procedurale të nenit 2 nga ana e UNMIK-ut, Paneli gjithashtu ka konsideruar UNMIK-u nuk ka shkelur nenin 3.

Megjithatë, sipas pikëpamjes së Panelit, pasi që mbetjet mortore të viktimës nuk janë gjetur dhe personat përgjegjës për kidnapimin dhe vrasjen e mundshme nuk janë sjellë para drejtësisë, obligimi procedural i paraparë në nenin 3 të KEDNj-së nuk është realizuar dhe se i njëjti është dashur të vazhdohet, edhe pse ka kaluar kohë e gjatë nga ndodhja e krimeve të supozuara. Kështu, pas përfundimit të procedurës në TNPJ-së, në përputhje me obligimin e vazhdueshëm për vazhdimin e hetimeve, kompetenca për një gjë të tillë do të duhej t'i ishte bartur EULEX-it, i cili më 9 dhjetor 2008 ka marrë kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë. Teksti i plotë i Mendimit të Panelit mund të shikohet këtu në [anglisht](#), [shqip](#) dhe [serbisht](#).

Cica Jankoviq kundër UNMIK-ut (lënda nr. 249/09)

Ankuesja është nëna e z. **Marjan Melonashi**, gazetar i redaksisë në gjuhën serbe të Radio Televizionit të Kosovës (RTK). Sipas ankueses, më 6 shtator 2000, rreth orës 14:10, djali saj kishte dalë nga zyrat e RTK-së, siç dukej, për të shkuar në shtëpi. Që nga ajo kohë vendndodhja e tij mbetet e panjohur.

Paneli erdhi në përfundim se UNMIK-u nuk ka zbatuar hetim të efektshëm për zhdukjen e z. Merjan Melonashit, duke shkelur kështu të drejtat e ankueses, të parapara në nenin 2 (procedurale) dhe se sjellja e UNMIK-ut ka kontribuar në vuajtjet shpirtërore të ankueses, duke shkelur kështu nenin 3 (substancial) të KEDNj-së. Teksti i plotë i Mendimit të Panelit mund të shikohet këtu në [anglisht](#), [shqip](#) dhe [serbisht](#).

Veçanërisht, Paneli ka shprehur shqetësimin se mosveprimi i autoriteteve tregon një masë të mosgatishmërisë nga ana e Policisë së UNMIK-ut për t'i ndjekur hetimet, posaçërisht në rastet kur ka pasur indikacione të dhunës së motivuar politikisht, të drejtuara kah personat e lidhur me UÇK-në. Teksti i plotë i Mendimit të Panelit mund të shikohet këtu në [anglisht](#), [shqip](#) dhe [serbisht](#).

Verica Patronogiq kundër UNMIK-ut (lënda nr. 252/09)

Ankuesja është bashkëshortja e z. **Mllagjan Mavriq**. Ajo deklaroi se bashkëshorti i saj është plagosur gjatë bombardimeve të NATO-s. Pas hyrjes së KFOR-it në Kosovë, ata qëndruan në fshatin Hoçë e Madhe të komunës së Rahovecit, deri më 12 tetor 1999, kur personat e panjohur e kishin kidnapuar z. Mllagjan Mavriq. Në nëntor të vitit 2003, ajo është njoftuar se mbetjet mortore të bashkëshortit të saj ishin gjetur më 22 nëntor 2002 në fshatin Brestovc dhe se procesi i identifikimit të tij kishte zgjatuar një vit. z. Mllagjan Mavriq është varrosur më 30 nëntor 2003 në Hoçë të Madhe.

Paneli erdhi në përfundim se UNMIK-u nuk ka kryer hetim të efektshëm për kidnapimin dhe vrasjen e z. Mllagjan Mavriq, dhe se ka bërë shkelje të nenit 2 (procedural) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Teksti i plotë i Mendimit të Panelit mund të shikohet këtu në [anglisht](#), [shqip](#) dhe [serbisht](#).

Millorad Andrejeviq kundër UNMIK-ut (lënda nr. 282/09)

Ankuesi është vëllai i z. **Dushan Andrejeviq**, serb i Kosovës. Ai deklaroi se më 11 qershor 1999, z. Dushan Andrejeviq dhe disa persona të tjerë po udhëtonin në komunën e Lipjanit në momentin kur ishte ndalur t'u ndihmonte disa kushërinjve të tij rreth një traktori të prishur. Ai ishte zhdukur prej grupit, me të cilin udhëtonte, dhe që nga ajo kohë vendndodhja e tij mbetet e panjohur.

Paneli erdhi në përfundim se UNMIK-u nuk ka kryer hetim të efektshëm për zhdukjen e z. Dushan Andrejeviq. Në bazë të kësaj, ka pasur shkelje të nenit 2 (procedural) dhe se përmes kësaj sjelljeje UNMIK-u ka kontribuar në shqetësimin dhe vuajtjen shpirtërore që paraqet shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Teksti i plotë i Mendimit të Panelit mund të shikohet këtu në [anglisht](#), [shqip](#) dhe [serbisht](#).
